

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: “ *Shtresë tapeti rrugët e vitit 2023* ”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **45210000-2**

PËRCAKTIMI DHE ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE :

Në përcaktimin e specifikimeve teknike, grupi i punës u mbështet në:

Specifikimet/Relacioni Teknik/preventive dhe grafiku per proceduren respektive jane hartuar nga grupi qe ka hartuar edhe projekt/ preventivin perkates te zbatimit specialiste te fushës nga Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit. *Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë kontrolluar dhe janë gjetur në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit nr.162 datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”.*Specifikimet Teknike jane pjese e setit te dokumentave te ngarkuara ne SPE per proceduren respektive.

Vendosja dhe argumentimi i kriterëve/Hartimi i kërkesave për kualifikim lidhur me kapacitetet teknike,argumentimi i numrit te punonjesve dhe numrit te mjeteve dhe makinerive për këtë objekt prokurimi është bërë nga specialisti i fushës, në respektim dhe të parashikimeve të nenit 74/4 të të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

VLERA E FONDIT LIMIT:

33.332.206.78*(tridhjetë e tre milion e treqind e tridhjetë e dy mijë e dyqind e gjashtë pikw shtatwdhjet e tetw) lekë pa tvsh*

Fondi Limit i perllogaritur per kete procedure eshte hartuar sipas manualit teknik per vitin 2024, në zbatim të urdhërit të brendshëm të titullarit të AK “Mbi Përgatitjen e kriterëve Teknike dhe Përllogaritjen e Vlerës Limit të planifikuar për tu kryer në programet e investimeve, bazuar ne dokumentat sipas buxhetit te bashkise te vitit 2024 të miratuara nga Këshilli Bashkiak si dhe dokumentave lidhur me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike të punimeve.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Maliq**_ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

SPECIFIKIMET

Germim dhe seksion i detyruar me shkarkim ne mjet

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m³ germim I detyruar ne rruge, panvaresisht nga kategoria e tokes me mjet te mekanizuar dhe ngarkim ne mjet. Germimi te behet duke patur parasysh detajet teknike dhe permasat sipas profilave gjatesor dhe terthor te rruges.

Transport dhe me auto deri 1 km.

Ne cmim perfshihet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per transportin e dherave ne nje vend te caktuar nga Investitori , por jo me larg se 1 km nga objekti.

Ndertim mur guri dekorativ llac cemento M 25

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m³ mur guri dekorativ ll.c. M=25 per ndertimin e mureve sipas detajit teknik me gjeresi dhe lartesi sipas projektit , pjesa ballore muret do te behet me fugatim. Ne cmim futet teresia e shpenzimeve per blerjen e materialeve rere guri, cemento, gure gerqelore, transportin. Ne cmim futet dhe testet e bera per marken e gurit. Llaci te prodhohet me betoniere ne objekt sipas kushteve teknike dhe standartet, me rere guri, te realizohet marka e kerkuare llacit.

Shtrese cakell makadam 10 cm

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m² shtrese cakell 0-50 me trashesi shtrese 10 cm, pas ngjeshjes me rul 12 ton duke patur parasysh kuotat ne profilat gjatesor dhe terthor te rruges, ndertimi i shtreses me cakell te behet (profilohet) me grejder dhe ngjishet me rul 12 ton duke bere dhe lagijen me uje , ne cmim futet teresia e shpenzimeve per blerjen e materialit , transportin shperndarjen e tij ne rruge dhe ngjeshjen e tij me rul sipas kushteve teknike . Materiali duhet te jete cakell mbeturine gurore me perzjerje argjile jo me shume se 15 %. Ne cmim futet dhe testet e bera per standartin e cakellit.

Shtrese stabilizant 10 cm + sperkatje me bitum

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m² shtrese stabilizant makinerie me trashesi 10 cm me pjerresi sipas profilave gjatesor dhe terthor dhe sperkatje 4 kg bitum / m² duke siguruar profilimin e rruges , ne cmim futet teresia e shpenzimeve per prodhimin ose blerjen e materialeve , transportin shperndarjen e tij ne siperfaqen e rruges dhe ngjeshjen e tij me rul 12 ton sipas kushteve teknike . Materiali duhet te jete I prodhuar me makineri me fraksion deri 30 mm , .Materiali duhet te ngjishet disa here me rul dhe kihet parasysh profilat gjatesor dhe terthor te rruges . Mbi shtresen hidhet prajmer ndertuar me bitum jo me pak se 0.5 kg per m² dhe mbi prajmerin hidhet nje shtrese granil. Shtresa te ruhet nga ndotjet . Ne cmim futet dhe testet e bera per standartin e cakellit.

Shtrese binder 5 cm

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m² shtrese binder , me trashesi 5 cm pas ngjeshjes me rul 12 ton shtrimi me makineri , dhe te sigurohen pjerresite sipas profilave gjatesor dhe terthor, ne cmim futet teresia e shpenzimeve blerjen e binderit , transportin sipas kushteve teknike shperndarjen e tij ne kasoneten e rruges dhe ngjeshjen e tij me rul 12 ton sipas kushteve teknike . Shtrimi i binderit te behet pasi jane pergatitur nenshtresat sipas kushteve teknike , testeve te bera te nenshtreses : Shtrimi te behet me makine shtrimi dhe ne nje kohe te pershtateshme

.Materiali i binderit te plotesoje te gjitha kushtet teknike shoqeruar me certificate cilesie. Ne siperfaqe te mos kete gropeza per mbajtjen e ujit. Ne cmim futet dhe testet e bera per standartin e binderit.

Shtrese asfaltobetoni 4 cm

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m² shtrese asfaltobetoni me trashesi 4 cm, pas ngjeshjes me rul 12 ton , dhe siguron pjerresite sipas profilave gjatesor dhe terthor, ne cmim futet teresia e shpenzimeve blerjen e asfaltit , transportin sipas kushteve teknike shperndarjen e tij ne kasoneten e rruges dhe ngjeshjen e tij me rul 12 ton sipas kushteve teknike . Shtrimi I asfaltit te behet me makine shtrimi dhe ne nje kohe te pershtateshme .Asfaltobetoni te plotesoje te gjitha kushtet teknike , shoqeruar me certificate cilesie .Ne siperfaqe te mos kete gropeza per mbajtjen e ujit. Ne cmim futet dhe testet e bera per standartin e asfaltit.

F.V. Bordura parafabrikat betoni C – 16 /20 .

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 ml bordure ne rruge dhe trotuar. Ne cmim futet teresia e shpenzimeve per blerjen e bordureve parafabrikat betoni, transportin shperndarjen e tyre,si dhe vendosja e tyre me topograf. Fiksimi I bordurave do te behet ne beton C – 16 / 20. Bordurat duhet te jene te shoqeruar me certifikaten e cilesise.

F.V. Tub korogato HDPE SN8, Ø =200,

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per furnizimin dhe vendosjen e 1 ml tubo korogato HDPE SN8 Ø =200 veper qe ploteson te gjitha kushtet teknike dhe kerkesave te projektit. Ne cmim futet teresia e shpenzimeve per piketimin germimin e dheut , ndertimin e shtreses te zhavorit , blerjen e materialeve , transportin dhe vendosjen ne veper sipas profilave terthor. Tubot duhet te jene te shoqeruar me certifikaten e cilesise.

Shtrese material i bute rreth tubos

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m³ shtrese material te bute mbi dhe ne tubot e P.V.C. ne cmim futet teresia e shpenzimeve per zgjedhjen e materijalit dhe shperndarjen e tij mbi dhe nen tubot plastike. Materiali bute te plotesoje te gjitha kushtet teknike te mos kete gure dhe material te forta qe demtojne tubot.

Ndertim pusete me zgare gize per ujrat e shiut. C – 16 / 20

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 cop pusete shiu 0.4x0.4x1ml me beton C – 16 / 20. Ne cmim futet teresia e shpenzimeve per germimin e dheut per prodhimin ose blerjen e materialeve inerte , cemento, transportin , pergatitjen e armaturave me derrese te stazhionuar ose metalike ,pergatitjen e betonit dhe hedhjen ne veper , ngjeshjen me vibrator , dhe trajtimin me uje per realizimin e markes te kerkuar dhe dizarmimin e armatures dhe per vendosjen e kapakun te gizes . Ne cmim futet dhe testet e bera per marken e betonit. Betoni te merrret I gatshem nga nje nyje e mekanizuar ose te prodhohet me betoniere ne objekt sipas kushteve teknike dhe standartet, me rere guri + cakell, te realizohet marka e kerkuare betonit.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3
- b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Deklarata për mjetet dhe punonjësit është e nevojshme për arsye se punimet duhet të realizohen në cilësi dhe afat dhe kërkohet sipas detyrës.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Per kapacitetin ligjor /profesional te operatoreve ekonomike:

Sipas kriterëve të përgjithshme të Pranim / Kualifikimit.

Operatori ekonomik duhet të ushtrojë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi, të paraqitur në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe vërtetuar nëpërmjet ekstraktit të regjistrit tregtar të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të vërtetuar të bilancit për vitet 2021, 2022, 2023 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

- i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;
- ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;
- iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël."

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme ,nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c) (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku

përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.2.2 Kopje të deklaratave për xhiron vjetore të viteve 2021,2022,2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin 9920 datë 19.05.2008 për “Procedurës Tatimore” neni 64 Deklarata Tatimore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar është bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: ” Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

Vendosja e ketij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore, për vitin 2023 ,pranë njësisve të qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitet sipas Ekstraktit të Rregjistrimit Tregtar dhe për vitin 2024 sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Bashkisë përkatëse, bazuar në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

* Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3 Kapaciteti teknik:”

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se ka

- a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së kontratës që prokurohet ,dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e

shpalljes se njoftimit te kontrates.

Ose

- b) Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e puneve te kryera, e marre se bashku gjate pese viteve te fundit te jete jo me e vogel se fondi limit i kontrates qe prokurohet.

Plotësimi i njërit prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

**Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomike, Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

Për të vërtetuar përvojën e suksesshme në ekzekutimin e një kontrate të ngjashme ne sektorin publik, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtem:

- Formular vlerësimi
- Situacion përfundimtar të objektit,

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Situacionin përfundimtar të objektit;
- Fatura tatimore
- Vertetim per kyerjen me sukses te kontrates

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanëpërvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat.40 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose sa vlera e fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.*

2.3.2 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatori ekonomik duhet të dorëzojë:

- a. Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

1. NP 1 - A (Punime germimi)
2. NP 4 - B (Punime rrugë, autostrada)
3. NS 18 - A (Punime topogjeodezike)

**Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

(Ne rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë licencat profesionale sipas zerave të preventivit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit merr persiper të realizojë).

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Vendimit Nr. 943, datë 28.12.2016 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 759, datë 12.11.2014, të këshillit të ministrave, “për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim” (shënim: përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor që parashikon licencimin në fushën e zbatimit të punimeve të ndërtimit, kategoritë e nevojshme të licencës, me emërtimin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës, duke përcaktuar edhe nivelin minimal të klasifikimit për çdo kategori, sipas vlerave të punimeve konkrete që do kryhen, si dhe institucionin që lëshon këtë licencë).*

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategori a e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimi i kërkuar për kategori në respektiv e	Vlera e punimeve (pa tvsh) që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP 1	<i>(Punime germimi)</i>	Punime germimi me eskavator	A	
NP 4	<i>Punime rrugë, autostrada</i>	Shtresa cakell stabilizant asfalti	B	
NS 18	<i>Punime topogjeodezike</i>	Punimet për vendosjen e kuotave në rrugë	A	

N.P-1A (Punime germimi në tokë)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me gjurmime në tokë, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

N.P-4A (Rruge ,autostrada,mbikalime etj)

Duke marrë në konsideratë objektin e prokurimit, i cili lidhet me sistemimasfaltim rruges , është e nevojshme që Operatori ekonomik të jetë i licensuar me kete kategori license.

NS 18 A (Punime topogjeodezike)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me punime per hedhje shtresash binderi ,cakull,asfalti dhe vendosje bordurash , ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një Deklarate ne formularin permbledhes te veteklarimit (nga Administratori i shoqërisë), Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë te perfshirë në licensën e shoqërisë. Drejtuesi teknik duhet te jete :

- Inxhinier Ndertimi (1)

“Në çdo rast, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatit te ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit te kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit,si më poshtë :

1. Kontratë pune (e vlefshme)
2. Diplomë

Ne rastin e Bashkimit te Operatoreve Ekonomik secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe natyrën e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në aktmarrëveshje".

Argumentimi: Për kriteret e përcaktuara në pikën 2.3.3. Njësia e Prokurimit është bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, "Për Prokurimin Publik" datë 23.12.2020, pika 4 si dhe në VKM nr 285 datë 19.05.2021 "për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" neni 39 pika 6 c.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Inxhinieri i ndërtimit është i nevojshëm për shkak të objektit të punës publike që prokurohet Pikërisht, sipas preventivit do të kryhen punime per shtrese asfalti dhe për rrjedhojë, është i nevojshëm inxhinieri i ndërtimit..

Inxhinieri ndërtimit është përgjegjës për zbatimin e saktë të projektit për secilin nga zërat e punimeve.Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve që vendosen në objekt

2.3.4 Operatori ekonomik, duhet të përcaktojë me anë të një **Deklarate sipas formularit permbledhes te veteklarimit** se për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- Inxhinier Gjeodet (1)

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

1. Kontratë pune (e vlefshme)
2. Diplomë

Argumentimi: Për kriteret e përcaktuara në pikën 2.3.3. dhe 2.3.4 Njësia e Prokurimit është bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, “Për Prokurimin Publik” datë 23.12.2020, pika 4 si dhe në VKM nr 285 datë 19.05.2021 “për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” neni 39 pika 6 c. Duke marrë parasysh natyrën e punimeve është kërkuar që drejtuesi teknik të jetë inxhinier ndërtimi. Përsa I përket stafit mbështetës është kërkuar :

Inxhinier gjeodet në lidhje me punimet për kuatat e rugeve .

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të deklarojë sipas formularit të vetdeklarimit se ka një punonjës i cili është i pajisur me Çertifikate trajnimi për “Pergjegjes për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në Pune”, e dhënë nga një organizim i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj

2.3.6 Shoqëria duhet të paraqesë Çertifikata ISO të vlefshme:

1. ISO 9001- 2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë).
2. ISO 14001-2015 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit).
3. ISO 45001-2018 (Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë)

Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH ose standardeve shqiptare mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë çertifikata ISO, sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Për kriteret e përcaktuara në Kapacitetin teknik, Njësia e prokurimit ka zbatuar VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 44 “Kërkesat e cilësisë” , si dhe bazuar në Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr.8197 prot. datë 03.09.2018 ,për “Hartimin e Kritereve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra,punë,shërbime. Autoriteti Kontraktor kërkon që operatori ekonomik të jetë i certifikuar me çertifikatat Iso .

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon

se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtare, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

2.3.7 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë ne formularin e vetdeklarimit se ka të punësuar, minimalisht 10 punonjës të kualifikuar si më poshtë:

- **Murator** (1)
- **Hidraulik** (1)

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

1. kontrata e punës e vlefshme;
2. Çertifikate për sigurimin teknik të punonjesve (e vlefshme);
ose
Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik

- **Manovrator** (3)

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

Kur mjetet janë ne pronesi

1. kontrata e punës (e vlefshme)
2. Dëshmi Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimeve të Transportit Rrugor

Kur mjetet janë me qera

Deklarate nga operatori ekonomik, që në rastin e shpalljes fitues, do paraqesë kontratë pune me manovratorin(i cili duhet të ketë Dëshmi Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimeve të Transportit Rrugor) deri në perfundimin e afateve të kontratës.

- **Punetore të thjeshte** (5)

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

1. kontrata e punës e vlefshme;

- **Murator (1)**

Bazuar në zërat e punimeve sipas preventivit Punime murature tulle ,kërkohet që operarori ekonomik të disponojë 1 murator të cilët do të realizojnë këto punime.

- **Hidraulik (1)**

Bazuar në zërat e punimeve sipas preventivit ,kërkohet që operarori ekonomik të disponojë 1 hidraulik që do të realizojë këto punime.

- **Manovrator (3)**

Bazuar në zërat e punimeve në preventiv për gërmim me eskavator dhe hedhje shtresash asfalti etj, AK ka kërkuar 3 manovratorë për drejtimin e mjeteve të renda.

- **Punetore të thjeshtë (5)**

Bazuar në zërat e punimeve në preventiv janë kërkuar dhe 5 punetore të thjeshtë për punimet e ndryshme.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Përprokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Vendosja e ketyre kriterëve për fuqinë punetore është bërë në përputhje me zërat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, që është perlllogaritur në një kohë të shkurtër i cili kërkon fuqi punetore të shtuar dhe me mjetet e kërkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate.

2.3.8 Operatori Ekonomik duhet të deklarojë në formularin e vetëdeklarimit se ka një punësim mesatar i të paktën 10 (dhjete) punonjësish për muajin e fundit.

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

a. **Vërtetim** të lëshuar dhe konfirmuar (me firmë dhe vule) nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit.

Dhe

b. **Listpagesat** e konfirmuar (me firmë dhe vule) nga Administrata Tatimore të punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit.

Kriteret e percaktuara ne piken 2.3.6. Eshtë kerkuar që operatori ekonomik të ketë një staf prej 10 punonjësit për të realizuar punimet ,nga zberthimi i preventivit të punimeve me manualin e miratuar me Vendimin Nr.629, datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre " Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pka 6, gërma "ç".

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve, prej gjithsej 10 punonjësish, është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të cdo zëri në preventiv si dhe grafikut në zbatim të punimeve, të cilat duhet të përfundojnë brenda afatit, mbështetur kjo në VKM Nr.629 datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre". Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë qëndrueshmëri të stafit pa shkëputje nga puna, dëshmi të cilat i japin garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj si dhe duke u mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur AK në zhvillimin e procedurave me objekt të ngjashëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t'u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj eshte kerkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" sipas së cilës: "Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës".

ZBERTHIM

I

OBJEKTI : SHITRESE TAPETI RRUGET E VITIT 2023

N r	Nr.An	EMERTIMI I PUNIMEVE	Njesi a	Sasi a	OP /NJ	OP GJITH
		SISTEMIM ASFALTIM FSHATI REMBEC L= 230 ml				
I		PUNIME NE RRUGE				
1	An	Fshirje rruge	m2	915	0.00 1	1
2	3.226/1	Shtrese asfaltobetoni t = 4cm	m2	915	0.09 5	87

		SHUMA I				0
		SISTEMIM ASFALTIM RRUGE LAGJIA LART SOVJAN L=500 ml				0
I		PUNIME NE RRUGE				0
1	An	Fshirje rruge	m2	1570	0.00 1	2
2	3.212/b	Shtrese stabilizanti t = 10cm + sperkatje	m2	800	0.07 5	60
3	3.222/1	Shtrese binderi t = 5cm	m2	800	0.10 9	87
4	3.226/1	Shtrese asfaltobetoni t = 4cm	m2	2370	0.09 5	225
		SHUMA II				0
		SISTEMIM ASFALTIM RRUGE FSHATI ORMAN L=820 ml				0
I		PUNIME NE RRUGE				0
1	An	Fshirje rruge	m2	1570	0.00 1	2
2	3.226/1	Shtrese asfaltobetoni t = 4cm	m2	3820	0.09 5	363
		SHUMA III				0
		SISTEMIM ASFALTIM RRUGE TE BRENDSHME POTGORIE L=400 ml				0
I		PUNIME NE RRUGE				0
1	An	Fshirje rruge	m2	1850	0.00 1	2
7	3.226/1	Shtrese asfaltobetoni t = 4cm	m2	1920	0.09 5	182
		SHUMA IV				0
		SISTEMIM ASFALTIM RRUGE TE BRENDSHME PODGORIE 2 L=180 ml				0
I		PUNIME NE RRUGE				0
1	An	Fshirje rruge	m2	900	0.00 1	1
2	3.226/1	Shtrese asfaltobetoni t = 4cm	m2	900	0.09 5	86
		SHUMA V				0
		SISTEMIM ASFALTIM FSHATI POJAN L=250 ml (KALLÇETO)				0
I		PUNIME NE RRUGE				0
1	An	Fshirje rruge	m2	1100	0.00 1	1
2	3.226/1	Shtrese asfaltobetoni t = 4cm	m2	1100	0.09 5	105
		SHUMA VI				0
		SISTEMIM ASFALTIM FSHATI POJAN L=950 ml				0
I		PUNIME NE RRUGE				0
1	An	Fshirje rruge	m2	4100	0.00 1	4
2	3.226/1	Shtrese asfaltobetoni t = 4cm	m2	4100	0.09 5	390

		SHUMA VII				0
		SISTEMIM ASFALTIM FSHATI TROVE				0
I		PUNIME NE RRUGE				0
1	An	Fshirje rruge	m2	900	0.00 1	1
2	3.226/1	Shtrese asfaltobetoni t = 4cm	m ²	925	0.09 5	88
		SHUMA VIII				0
		SISTEMIM ASFALTIM FSHATI VASHTEMI AVDOLLARET L=350 ml				0
I		PUNIME NE RRUGE				0
1	An	Fshirje rruge	m2	1800	0.00 1	2
6	3.226/1	Shtrese asfaltobetoni t = 4cm	m2	1800	0.09 5	171
		SHUMA IX				0
		SISTEMIM ASFALTIM FSHATI ZEMBLAK L=450 ml				0
I		PUNIME NE RRUGE				0
1	An	Fshirje rruge	m2	2440	0.00 1	2
2	2.26	Germim dheu me eskavator me goma 0.25m ³ ne kanale me gjeresi > 2m toke e zakonshme kategori III me shk ne mjet	m3	30	0.06 2	2
1	2.25	Germim dheu me ekskavator me goma 0.25m ³ , kanal me gjeresi deri 2m, tok e zakonshme, kat. III, shkarkim ne toke	m3	25	0.07	1.68
3	3.158/1a	Transport dheu + mbeturina nder ne distanc 1 km	m3	30	0.1	3
4	An	F.V. Tuba te brinjazuara HDPE SN8 d=200mm	ml	50	0.6	30
5	3.47/1a	Hedhje, rafshim ,mbushje dheu me krahe kat e III	m3	22	1.25	28
7	An[Ndertim puseta 40x40, h=100cm me zgare gize per ujrat e shiut	cop	2	4.2	8
8	3.617	F.V. Bordura rruge e parafabrikuar 15x25 cm	ml	50	0.6	30
9	3.207	Shtrese cakulli makadam t = 10cm	m2	270	0.04 5	12
10	3.212/b	Shtrese stabilizanti t = 10cm + sperkatje	m2	270	0.07 5	20
11	3.222/1	Shtrese binderi t = 5cm	m2	270	0.10 9	29
12	3.226/1	Shtrese asfaltobetoni t = 4cm	m2	2680	0.09 5	255
		SHUMA X				0
		SISTEMIM RRUGE KRASTAFILAK L=250 ml				0
I		PUNIME SHTRESASH NE RRUGE				0
1	An	Fshirje rruge	m2	1300	0.00 1	1
2	3.323	Mur mbajtes me gur mozaik llac çm M-25	m3	12	9.3	112
7	3.226/1	Shtrese asfaltobetoni t = 4cm	m2	1300	0.09	124

					5	
						SHUMA XI
						2,515

- Nga zberthimi i preventivit oret e punes per cdo ze punimi rezultojne 2515.
- Oret në total i pjestojmë me 8 orë pune ditore 2515: 8 = 314.
kemi 314 punëtorë për një ditë pune
- 314 punëtorë për një ditë punë pjestuar më 22 ditë pune mujore kemi 15 punëtorë për një muaj punë.
- Rezulton 10 punetore shpërndarë sipas grafikut per 2 muaj .

2.3.9 Operatori ekonomik duhet te deklaroje ne formularin e vetdeklarimit se ka ne pronesi ose me qira mjetet e domosdoshme per realizimin e kontrates si me poshte :

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
1. Kamion vetshkarkues me mase maksimale te autorizuar sipas lejes se qarkullimit nga 16 ton deri 18 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
2. Kamioncine me mase maksimale te autorizuar sipas lejes se qarkullimit 3.5 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
3. Betoniere	2 copë	Pronësi ose me qera
4. Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
5. Asfaltoshtruese	1 copë	Pronësi ose me qera
6. Autobitumatrice	1 copë	Pronësi ose me qera
7. Rul	1 copë	Pronësi ose me qera
8. Grejder	1 copë	Pronësi ose me qera
9. Eskavator	1 copë	Pronësi ose me qera

“Në çdo rast, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatit te ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit te kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:

1. Leje qarkullimi (e vlefshme)
2. certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
3. Police sigurimi (e vlefshme)
4. Mjeti te shoqerohet me fotografi te dukshme
5. Certificate per leje transporti te leshuar nga Bashkia

dhe per mjetet me qera,

1. Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

2. *Leje qarkullimi (e vlefshme)*
3. *Certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)*
4. *Police sigurimi (e vlefshme)*
5. *Mjeti te shoqerohet me fotografi te dukshme.]*
6. *Certifikate per leje transporti te leshuar nga Bashkia*

Ne rastin e mjeteve te marra me qera nga operatoret ekonomike bazuar ne njoftimin e APP nr. 4916/2 prot date 14.07.2022 ,referuar dokumentacionit(leje qarkullimi,certifikate e transportit te mallrave) ,mjetet nuk duhet te rezultojne per perdorim vetjak por per perdorim nga te tretet.

b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten :

per mjetet ne pronesi :

- aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

per mjetet me qera :

*- të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.
- aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

1- kamion vetshkarkues 2 copë

jane kerkuar 2 kamion vetshkarkues per transportin e materialeve te ndryshme per shtresat ne rruge..

2- betoniere 1 copë

Bazuar në zërin e preventivit për punime murature eshte kerkuar 1 motobetoniere.

3- Kamioncine 1 cope

Eshte kerkuar 1 kamioncine 3.5 ton per transportin e materialeve dhe punetoreve ne vendin e punes.

4- Autobot uji 1 cope

Eshte kerkuar 1 autobot uji per punimet e muratures dhe suvatimit.

5- eskavator 1 cope

Bazuar ne zerat e preventivit per germim dheu me eskavator eshte kerkuar nje eskavator per kryerjen e punimeve

6- grejder 1 cope

Eshte kerkuar nje grejder per nivelim te shtresave

7- rul 1 cope

Bazuar ne zerat e preventivit per punime shtresash eshte kerkuar nje rul per nivelim dhe ngjeshje te shtresave.

8- autobitumatrice 1 cope

Eshte kerkuar nje bitumatrice per sperkatjen me bitum

9- Asfaltoshtruese 1 cope

Bazuar ne zerat e preventivit per punime asfalti eshte kerkuar nje asfaltoshtruese.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).